MBRETNIJA SHQIPTARE

KRYESIA E KËSHILLIT MINISTRUER

Regullore e përgjithshme e CEREMONIVE

BOTIM' I DYTË

Shtyp. «Tirana» — Tiranë

1929

BKSH

BKSH

MBRETNIJA SHQIPTARE

KRYESIA E KËSHILLIT MINISTRUER

Regullore e përgjithshme e CEREMONIVE

BOTIM' I DYTË

Shtyp. «Tirana» — Tiranë

1929

BKSH

ВКSH

SEKSIONI I Irë

RADHET E PARANDEJNJET

Art. 1.

Në Mbretnin Shqiptare radhet e parandenjet e autoriteteve qi marrin pjesë në solenitete zyrtare janë caktue në mënyrën qi vijon:

Kategorija e Irë.

Klas'i I	Kryeministri
	Kryetari i Parlamentit
	Kolie i Math i Shqipnis
	Klasi i parë i Urdhnit Trimnis
Klas'i II	Ministrat e Shtetit
	Komandanti i Mprojtjes Kombtare
	Deputacion Parlamentar
	Kordon i Math i Urdhnit Besa

Kategorija e IItë.

Klas'i I	Ministri i Oborit
	Adjutanti i I. i Nalt Madhënis së Tij Mbretit
	Kryetari Departamentit Ushtarak pranë Oborit

BKSH

Klas' i I	Kryetari Departamentit të Gjendarmeris pranë Oborit
	Kryetari i Shtabit Madhënuer
	„ i Këshillit të Shtetit
	„ i Diktimit (d. c.)
	„ i Diktimit (d. p.)
	Kryeprokurori i Shtetit
	Kryetari i Këshillit Kontrollues
	Kordon i Math i Urdhnit Skender Bej
Klas' i II	Ministrat Fuqiplotë
	Generalat
	Komandanti i P. i Gjendarmeris
	Prefektat e Klasit të I.

Kategorija e IIItë.

Klas' i I	Drejtorët e Përgjithëshëm
	Sekretarët e Përgjithëshëm
	Inspektorat e P. pranë Oborit
	Kryesekretari i Oborit
	Antarët e Diktimit
	„ e Këshillit të Shtetit
	Prefekt i Kryeqytetit
	Ministrat Resident
	Kryetarët e Komuniteteve Fetarë
	Prokurori i Këshillit Kontrollues
Klas' i II	Antarët e " " "
	Prefektat e Klasit të II.
	Komandanti i Entit Kombtar
	Presidenti i Bankës Kombtare
	Inspektorët e Ministrive

Gazeta e Kr... viti 1966

BKSH

Kategorija e IVtë.

Të ngarkuemit me Punë titullar, Prefekti i Tiranës, Kolonelat Komandanta - Inspektora - Kryetar Zyre - Kolonela - Nën-kolonela Komandanta - Inspektora - Kryetar Zyre - Nen-Kolonela, Kryetari i Gjyqit Politik, Kryetari i Gjyqit Ushtarak, Kryetari i Gjyqit Shkallës Irë, Inspektorat e Ministrive - të Drejtotrive të Përgjithëshme, Drejtori i P. i Kryqit Kuq, Nnihmës Kryeprokurorri i Diktimit, Ndihmës Anëtarët e Këshillit të Shtetit, Nidhmës Anëtarët e Diktimit, Sekretari i P. i Këshillit të Shtetit.

Kategorija e Vtë.

Drejtorët e Shefat e Seksioneve të Ministrivet, Drejtori i Shtypit, Drejtori i Pensioneve, Drejtori i Hypothekave dhe Kadastrës, Shefat e Drejtorive të Përgjithëshme, Konsujt Gjeneral, Këshilltar Ligjuer, Komisar Qeverive pranë Bankës dhe Shoqërive, Shefi i Kabinetit të Kryeministris, Komisar Bashkije të Prefekturave, Prokurori Gjyqit Politik i Gjyqit Ushtarak - i Gjyqeve Shkallës Parë, Majora Komandanta - Inspektora -Shef Zyre - Majora, Drejtorët Shkollës Mesme - Drejtori i Shkollës Teknike, Drejtorë Bibliotheke - Drejtor Spitali të Shtetit Drejtora Institutash anologe, Inxhinjerat Kl. I - Agronom, Inxhinjer arshitekt Kl. I - Veterinar Kl. I.

B) Për nëpunësa qi s'marrin pjesë në solenitetet

zyrtare radha e tyne caktohet si mbas pasqyrës së klasifikimit të përgjithshem të nëpunësavet.

Art. 2.

Kuer se në ndonji Ministri ose në ndonjë deg tjetër ndodhen dy fonkcjonarë qi kanë nji gradë, atëherë, për radhën e tyne merret para syesh data e dekretit. Në qoftë se dekretet e tyne janë të nënshkrueme në nji ditë, atëherë, merret para sysh data e dekoratës Kombëtare qi mbajnë; po të jenë qi s'kanë dhe dekoratë, atëherë, merret para sysh data e hymjes së tyne në sherbimin e Shtetit.

Art. 3.

Kuer se Trupi Diplomatik (en groupe) merrë pjesë në ndonji festë zyrtare radha e tij vjen para gjith autoriteteve shenueme n'art. 1.

Art. 4.

Dispozitat e përmenduna n'art. 1 e 2 aplikohen dhe për drekë e darkë zyrtare.

Në kjoftë se nër këto drekë ose darkë ndodhen dhe Kryetarët e Misjoneve Diplomatike bashkë me Ministrat e Kabinetit, parandejnjet (préséances) ju jepen të huejvet dhe vendet caktohen në këtë mënyrë:

Nji Ministër i Huej e nji Minister Kabineti.

Gjithashtu nër drekë ose darkë qi nepen prej të huejvet e qi marrin pjesë Ministrat Shqiptarë, reciprokisht, parandejnjet (préséances) ju nepen shqiptarvet dhe vendet caktohen si vijon:

Nji Ministër Shqiptarë e nji Ministër i huej.

Art. 5.

Radha e Attachés Militaires-vet vjen mbas asaj të Komandantit të Përgjithëshem t'Ushtrīs.

Po të jenë Attaché Militaire-i ka gradën e nji Gjenerali, atëherë, ky merrë vend ma parë se Gjeneralat Shqiptar t'atij Gradi.

Art. 6.

Zonjat përgjithësisht marrin vend si mbas gradës burrave të tyne.

Art. 7.

Personat të tjera qi marrin pjesë nër këto drekë ose darkë zyrtare radhohen si mas mënyrës shenue n'art. 1.

Art. 8.

Për as ndonji arësye kërkush nuk mund të pretendojë të ketë nji vend ma të naltë ose ma t'ultë në rastë zyrtarë, përveç atë qi cakton kjo rregullore.

Art. 9.

NË PREFEKTURAT E NË-NPREFEKTURAT

a) *Prefekti* ose *Nënprefekti* - ku ndodhen Grup Komandanti Komandanti vjen mbas mbas prefektit, - Kryetarët e Besimeve, - Gjykatësi i Shkallës Irë dhe i Paqit - Pro-

BVSH

kurori i Ushtris e i Gjindarmaris - Drejtori i Financës - Drejtori i Botores - Inspektori i Arësimit - Kryetari i Bashkis - Kryetari i Dhomës Tregtare - Komiseri ose Nën-Komiseri i Policiës - Noteri.

b) Dispozitat e paragrafit b t'art. 1 aplikohet dhe në Prefekturat e në Nënprefkturat.

Art. 10

Kur se në Prefekturat ose Nën-prefekturat në rasë të nji festës zyrtare ndodhen dhe Deputet, atëherë, këto radhohen para Kryetarëve të Besimeve dhe Grup Komandantit.

Art. 11.

Kur se në ndonji Prefekturë ose Nën-prefekturë marrin pjesë në nji festë zyrtare dhe konsujt e Huej, radha e këtyne vjen para autoriteteve të përmenduna n'art. 10.

Art. 12.

Dispozitat e përmenduna n'art. 9 e 100. aplikohen dhe për drekët e darket zyrtare.

Art. 13.

Në kjoftë se nër këto drekë ose darkë ndodhej dhe konsujt e huej parandejnjet (préséances) ju jepen këtyne të fundit tue radhue nji të huej e nji autoritet shqiptar.

Ner këto raste për klasifikimin e konsujvet merret para sysh :

BKSH

a) Grada e tyne,

b) Kur se grada asht baras, atëherë, merret para sysh data e paraqitjes së tyne zyrtarisht për të parën herë në Prefekturë ose në Nën-prefekturë.

Art. 14.

Dispozitat e art. 8 aplikohen në Prefekturat e Nën-Prefekturat.

SEKSJONI I Ilte

PRITJET ZYRTARE PËR KRYETARET E SHTETIT

Art. 15.

Për pritjen zyrtare në Shqipni të Suveranëvet, t'Anëtarëvet të Familjeve Mbretnore të Hueja, të Regjentave dhe të Kryetarëve të Republikave, në sejcilën rasë, Mbas Urdhënit të Nalt-Madhnis së Tij Mbretit, Ministri i Oborit s'bashku me të ngarkuemin e Protokolit të Ministris P. të Jashtme cakton nji program të veçantë.

PRITJA PËR PARAQITJEN E LETRAVE KREDENCJALE

Art. 16.

Audjenca solenele për paraqitjen e letrave kredencjale caktohet mbas Urdhënit të Nalt-Madhënis së Tij Mbretit prej Ministrit t'Oborit.

Pikë

Natura e letrave kredencjale të tyne tregon kualitetin qi kanë.

Ministrat Resident kalojnë gjithmonë mbas të fundit Minister Fuqiplotë.

Art. 21.

Të ngarkuemit me punë qi janë akreditue me letër të Ministrit të P. të Jashtme, kanë parandejnje (préséance) mbi ato qi përmbushin nji sherbim zavendësije (ad interim).

Art. 22.

Kuer se Diplomatët për ndonji arësye ridorëzojnë letra kredencjale, këto vazhdojnë të mbajnë midis tyne radhën qi sejcili kishte ma parë.

APLIKIMI I DISPOZITAVE TË . . . .
NË PREFEKTURAT E NË NËN-PREFEKTURAT

Art. 23.

a) Kuer se Prefekti ose Nën-Prefekti merrë në dorëzim zyrën e tij, të gjitha autoritetet qi mvaren prej tij u bajnë vizitën e parë.

Përgjithsisht ç'do autoritet qi emnohet në nji Prefekturë ose Nënprefekturë i banë vizitën e parë Prefektit ose Nën-Prefektit.

Nëpunsat subaltern i bajnë vizitë superiorit të tyne kuer se ky i fundit emnohet i ri në detyrë.

b) Prefektat ose Nën-Prefektat kur se arrijnë në

Natura e letrave kredencjale të tyne tregon kualitetin qi kanë.

Ministrat Resident kalojnë gjithmonë mbas të fundit Minister Fuqiplotë.

Art. 21.

Të ngarkuemit me punë qi janë akreditue me letër të Ministrit të P. të Jashtme, kanë parandejnje (préséance) mbi ato qi përmbushin nji sherbim zavendësije (ad interim).

Art. 22.

Kuer se Diplomatët për ndonji arësye ridorëzojnë letra kredencjale, këto vazhdojnë të mbajnë midis tyne radhën qi sejcili kishte ma parë.

APLIKIMI I DISPOZITAVE TË . . . .
NË PREFEKTURAT E NË NËN-PREFEKTURAT

Art. 23.

a) Kuer se Prefekti ose Nën-Prefekti merrë në dorëzim zyrën e tij, të gjitha autoritetet qi mvaren prej tij u bajnë vizitën e parë.

Përgjithsisht ç'do autoritet qi emnohet në nji Prefekturë ose Nënprefekturë i banë vizitën e parë Prefektit ose Nën-Prefektit.

Nëpunsat subaltern i bajnë vizitë superiorit të tyne kuer se ky i fundit emnohet i ri në detyrë.

b) Prefektat ose Nën-Prefektat kur se arrijnë në

krye të detyrës me nji notë i bajnë të njoftun ardhjen e tyne konsujve, Nen-Konsujve ose Agjentave Konsulluer qi ndodhen në juridikacjonin e tyne, dhe këta ju bajnë vizitën e parë Prefektit ose Nënprefektit.

Këjo vizitë këthehet mbrenda 24 orëve.

Art. 24.

Kuer se anije-lufte e huej arrijnë në limanin e nji Prefekturës ose të nji Nën-Prefekturës, Komandanti i anijës i banë Prefektit ose Nën-prefektit vizitën e parë.

Këjo vizitë i këthehet Komandantit n'anijë po atë ditë, e veshja asht jacquette à taille cilinder (kapel e naltë).

Art. 25.

Kuer se nër raste të kremtimeve Kombëtare në Prefekturat ose në Nen-Prefekturat bahen pritje zyrtare në qoftë se në këto ndodhen Konsujt, Nën-Konsujt ose Agjentat Konsulluer, këto lajmohen 48 orë përpara ditës së pritjes.

Në këtë rastë aplikohet dispozita e art. 11.

Art. 26.

Kuer se nji Konsullatë e huej kremton festën Kombëtare të Shtetit të tij e në këtë rast fton dhe autoritetet t'ona, këto të fundit venë n'oren e caktueme në ftesë duke qenë të veshun me jacquette à taille cilinder (kapel e naltë).

BKSH

FUNERALET QI BAHEN PËR AGJENTAT DIPLOMATIK TË HUEJ

Art. 36.

Kur vdes nji Agjent Diplomatik i Huej, Ministri i P. të Jashtme lajmon mbi këtë vdekje Shefin e Protokolit dhe Agjentin Shqiptar të akredituem pranë Qeveris qi përfaqësonte i vdekuni.

Ceremonija e funeralevet rregullohet prej zyrës së Protokollit tue u marrë vesht me Doyen-in (Dekanin) e Trupit Diplomatik.

Nderime Funebre për Agjentat Diplomatik të Huej bahen si mbas rregullores të pranueme për Funeralet e Ministratvet Shqiptarë.

Art. 37.

Kio regullore hyn në fuqi prej ditës së shpalljes në fletoren zyrtare.

Art. 38.

Regullorea e Ceremonive më . . . . . është e anulume.

Art. 39.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj regullorje.

Bkgj

FUNERALET QI BAHEN PËR AGJENTAT DIPLOMATIK TË HUEJ

Art. 36.

Kur vdes nji Agjent Diplomatik i Huej, Ministri i P. të Jashtme lajmon mbi këtë vdekje Shefin e Protokolit dhe Agjentin Shqiptar të akredituem pranë Qeveris qi përfaqësonte i vdekuni.

Ceremonija e funeralevet rregullohet prej zyrës së Protokollit tue u marrë vesht me Doyen-in (Dekanin) e Trupit Diplomatik.

Nderime Funebre për Agjentat Diplomatik të Huej bahen si mbas rregullores të pranueme për Funeralet e Ministratvet Shqiptarë.

Art. 37.

Kio regullore hyn në fuqi prej ditës së shpalljes në fletoren zyrtare.

Art. 38.

Regullorea e Ceremonive më 11-XI-926 ësht e anulume.

Art. 39.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj regullore.

Bksh

Kryeministri e
Ministri i P. Mbrendshme:
K. Kotta. d. v.

Ministri i Drejtësis:
H. Delvina. d. v.

Minis. i P. të Jashtme:
R. Fico. d. v.

Ministri i Arësimit:
A. Dibra. d. v.

Minis. i Financavet:
M. Tutulani. d. v.

Minis. i P. Botore:
S. Vuçiterni. d. v.

Ministri i Ekonomis Kombëtare:
Musa Juka. d. v.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 17-VI-929.

Dekreton

Aprovimin dhe zbatimin e Dispozitave mbi Rregulloren e Përgjithyshme të Cerëmonis.

Tiranë, më 25 Qershuer 1929.

Z O G d. v.

Vërtetohet se asht nji me kopjen e origjinalit
Sekretari i Përgjith. i Kryesis së Këshillit Ministruer
T. Selenica d. v.

BKSH

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME
mbi
VIZITAT, VESHJA-MBAJTJA E DEKORATAVE

) Në regullat e përgjithëshme, kthimi i vizitave zyrtare asht i detyrueshëm për të gjithë.

APLIKIMI I DISPOZITAVE TË PËRGJITSHME NË KRYEQYTET,

A) V I Z I T A T

Art. 1.

Kërkush nuk mund të depozojë kartë-vizite N. M. Tij Mbretit dhe Familjes Mbretnore.

Personat qi dëshirojnë me paraqit nderimet e tyne N. M. Tij Mbretit ose anëtarëvet të Familjes Mbretnore, nënshkruhen në regjistrat e posatshem qi gjinden në dispozicion në Ministrin e Oborit e në Pallatin e Familjes Mbretnore.

Art. 2.

a) Ministrat e huej mbasi të kenë paraqitun letrat kredenciale bajnë vizitat e para personave poshtë shenueme :

Kryeministrit, Kryetarit të Parlamentit - Minis-

trave të Kabinetit - Komandantit të Përgjiëshem të Mbrojtjes Kombëtare - Kryetarit të Shtatit Madhnuer - Ministrit t'Oborit - Kryeadjutantit.

Këto vizita bahen tue depozue kartë-vizita dhe kthehen mbrenda 24 orëve.

b) Kart-vizitat që depozohen të ngarkuemit me punë (Chargé d'Affaires) kthehen mbrenda 48 orëve.

c) Kart-vizitat qi depozohen nga Sekretarët e Irë të Legatave e nga Attachés Militaires-të këthehen mbrenda nji javës.

d) Për Sekretarët e tjerë të Legatave e për personat e tjerë qi bajnë pjesë të Legatës, ju kthehen kart-vizitat brenda nji javës, me ndryshim të vetëm qi këto kart-vizita, me anën e nji njeriut dërgohen të pa thyem e në nji zarfe të çelun mbi të cilën shkruhet emri i t'interesuemit.

e) Kart-vizitat qi dërgohen me inicialet p. f. (për urime), kthehen me inicialet p. r. (për falenderime).

f) Kartë vizitat qi dërgohen me inicialet p. p. c. (për lamtumire) nuk këthehen.

g) Mbas nji ftese në nji drekë ose darkë kthehet përgjithësisht kartë vizitë mbrenda nji javës.

Në kjoftë se ftuesi asht i martuem, atëherë kthehen dy kartë vizita.

h) Kartë vizitat që merren me inicialet p. r. (për faderim nuk këthehen.

i) Në rast të ditës së parë të vjetit, çkëmbehen kartë vizita të cilat mund të dërgohen dhe në nji zarf të çelun me anën e postes.

BKSH

Art. 3.

Në rregullat e përgjithëshme asht gjithë-herë inferiori me gradë qi ban ma parë vizitë ose depozon kartëvizitat.

Për personat e martuem depozohen dy kartë vizita.

Art. 4.

Në ftesat për drekë ose për darkë duhet përgjegjun mbrenda 24 orëve në se i ftuemi e pranon ose jo.

B) V E S H J A

Art. 5.

N'audiencën solenele e nër pritjet zyrtare n'Oborin Mbretnor veshja asht Grande Uniformë, Frack, petka Kombëtare e të gjitha dekoracionet.

Art. 6.

a) Për audienca private n'Oborin Mbretnor veshja asht frak, bonjour, petka kombëtare.

b) Për audienca private të Kryetarëvet të Misionevet Diplomatike të Huej, veshja asht redingot bonjour.

c) Për audienca ordinare për nënshtetasit e huej veshja asht frak, bonjour.

d) Për audienca pranë Familjes Mbretnore veshja asht përgjithsisht redingot, bonjour ose petka kombëtare.

BKSH

Art. 7.

a) Për vizitat zyrtare si dhe për vizitat qi bahen nër legatat e huaja në rasë të festës kombëtare të tyne përgjithsisht veshja asht jacquette à taille.

b) Kuer të huejt bajnë vizitë zyrtare në Ministri veshja asht jacquette à taille.

c) Për drekat zyrtare veshja asht jacquette àtaille.

d) Për drekat qi nuk kanë nji karakter zyrtarë mund të vehet edhe petka ordinare në ngjyrë të mbyllët.

Art. 8.

Për darka përgjithsisht veshja asht frak në kjoftë se në letrë ftesë nuk asht shenjue nji veshje tjetër.

Art. 9.

Për ballo e për soire-ra, përgjithsisht asht e detyrueme të veshet frak.

Art. 10.

Në funeralet zyrtare veshja asht radingot, jacquette à taille cilinder (kapele e naltë).

C) MBAJTJA E DEKORATAVE

Art. 11.

a) Në rregull të përgjithshem dekorata kombëtare xen vent përpara të gjitha dekoratave të tjera të hueja pa marrun parasyesh grada e këtyne të fundit.

b) Në rast të kremtimeve të ditës Grand Cordon-i varret mbi giletin.

BKSH

Art. 12.

Në darkat, në bale e nër soire-ra zyrtare, në kjoftë se asht shenue në ftesat mbajtja e dekoratave, këto vehen në këtë mënyrë:

a) Kur asht shenue (dekorata e vogel) vehen vetëm miniaturat të cilat varen në të thyemen e majt të frakut.

b) Kur asht shenue (edkorata e plaket) vehen dekoracionet, plaket, por jo kordonat.

c) Kur asht shenjue (dekoratat e Grand Cordon) ateherë bashkë me plaket vehet dhe Cordon-i por nën giletin.

d) Në festimet e mbramjes Grand Cordoni vehet mbi giletin vetëm me presencën e N. M. së Tij Mbretit.

Art. 13.

Kur se nji person mban përveç Grand Cordonin kombëtar dhe të tjera Grand Cordone të hueja mbartja e tyne asht në këtë mënyrë:

Në rastë solenele kombtare vehet Grand Cordon-i Kombëtar e për të tjerë grand Cordone vehen vetëm plaket e tyne.

Në kjoftë se në nji solenitet Kombëtar të nji Shteti të Huej, personi qi asht i ftuem ka edhe Grand Cordon-in e atij Shteti, atëherë venë këtë Cordon dhe plaket e të tjeravet.

BKSH

BKSH

AR/1381

KONTROLLI
1974-1976

BKSH

V
1989

BKSH